



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Duke u bazuar në dispozitat e Rregullorës nr. 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022 për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve dhe Planin të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, masa P7, Drejtoria e Mobilitetit shpall këtë:

THIRRJE

për aplikim për licencimin e operatoreve ekonomik të ri për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve për Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik)

I. Taksi Kompani (Person juridik) për tu licencuar për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

1. Dëshmi se është i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
2. Dëshmi se ka selinë në territorin e Kryeqytetit;
3. Dëshmi se posedon flotën prej minimum 10 (dhjetë) vetura dhe maksimum 40 (dyzet) vetura;
4. Dëshmi se është pronar/e i/e veturave me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing), të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe nenit 4 Rregullores nr. 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022 për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve;
5. Dëshmi se posedon hapësirë parkingu për vetura në pronësi të tij/saj ose të kontraktuar;
6. Dëshmi se posedon numrin e vend parkimeve të njëjtë me numrin e veturave për të cilat ka licencë;
7. Dëshmi se posedon sistem të digjitalizuar për menaxhimin e porositve me mundësinë e zgjedhjes shoferit/es në rastet kur kompania ka të punësuar shofere gra;
8. Dëshmi se posedon së paku 1 (një) veturë në çdo 10 (dhjetë) vetura të flotës të përshtatshme për persona më aftësi të kufizuara;
9. Dëshmi se është i/e pajisur me arkë fiskale, sipas vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK);
10. Dëshmi se është i/e pajisur me POS bankar në të paktën 1 (një) në çdo 10 (dhjetë) vetura të flotës;
11. Dëshmi që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj) për pronarin/en dhe punëtorët;

12. Certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj) për pronarin/en dhe punëtorët.
1. Për shoferët kopje e patente shoferit për kategorinë "B" (kjo vlen për OE të cilët e kanë të kompletuar flotën, ndërsa OE të cilit aplikojnë me kredi kopjet e lejeve mund ti dozojnë gjatë fazës së kompletimit të flotës).
13. ;
14. Dokumentacionin e regjistrimit dhe gjendjes teknike të automjeteve për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
15. Viti i prodhimit të jetë jo më i vjetër se 8 (tetë) vite;

II. Taksi Individual apo Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët aplikojnë për tu licencuar për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

2. Dëshmi se është pronar/e i/e veturës me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing), që i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje;
3. Dëshmi se është i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
4. Dëshmi se është banor/e i/e Kryeqytetit (dëshmi për vendbanim);
5. Dëshmi se është i/e pajisur me arkë fiskale, sipas vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK);
6. Certifikatën që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
Certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj);
7. Kopjen e patentë shoferit për kategorinë "B" (kjo vlen për Persona Juridik të cilët e kanë në posedim automjetin, ndërsa Personat Juridik të cilit aplikojnë me kredi kopjet e lejeve mund ti dozojnë në momentin që e kanë në posedim automjetin).

III. Vetura duhet ti plotësoj këto kushte:

1. Të jetë me pesë (4+1) ulëse;
2. Të ketë timonin në krahun e majtë dhe të ketë së paku katër (4) dyer;
Të jetë hibrid dhe/apo elektrik;
3. Të jetë i pajisur me **taksimetër manual/digjital**, i cili duhet të jetë në gjendje të rregullt teknike, i ekuilibruar (bazhdaruar) për çdo vit, i atestuar dhe i vulosur në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara për taksimetrat, si dhe të jetë i vendosur në një vend të dukshëm dhe të qasshëm për udhëtarin. Lejohet përdorimi i **taksimetrit manual/elektronik (klasik)**, si dhe i **taksimetrit digjital**, përfshirë sistemet që funksionojnë përmes aplikacionit. Në rast të përdorimit të taksimetrit digjital ose të një sistemi të bazuar në aplikacion, sistemi konkret duhet të jetë i **miratuar për përdorim si mjet matës ligjor**, të ketë kaluar procedurat përkatëse të **vlerësimit të konformitetit** dhe të posedojë **certifikatë të vlefshme të verifikimit**, të lëshuar ose të njohur nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ose nga institucioni kompetent i autorizuar.

(OE certifikatën për taks metër mund ta dorëzoj pasi shpalljes se i ka plotësuar kriteret, mirëpo nuk mund ta tërheq Licencën pa dëshmi të taksimetrit);

4. Të jenë në rregull teknikisht me klimatizim për rregullim të temperaturës (AC funksionale);
5. vetura të jetë e pastër dhe pa dëmtime;

6. vetura të ketë bazën ngjyrë të verdhë për taksi individual dhe të bardhë për taksi kompani;
7. të ketë aparatën kundër zjarrit dhe dëshminë se është testuar brenda 6 muajsh,, të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm;
8. vetura të jetë teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve.

IV. Organizimi:

1. Organizimi përmes platformave digjitale;
2. Organizimi, rezervimi dhe menaxhimi i shërbimeve të transportit taksi mund të realizohet edhe përmes platformave digjitale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
3. Përdorimi i platformës digjitale nuk e përjashton operatorin, automjetin dhe shoferin nga plotësimi i kushteve të licencimit dhe obligimeve ligjore.

V. Licenca:

1. Operatorët që plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë thirrje dhe legjislacionin në fuqi do të pajisen me Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, me kohëzgjatje prej **pesë (5) viteve**, me mundësi vazhdimi.
2. Afati maksimal për liferimin e veturave, funksionalizimin e flotës do të jetë **1 vit** nga dita e pajisjes me “Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve”, në rast të mos përmbushjes së tyre gjatë këtij afati e njëjta do të shfuqizohet.

V. Aplikimi:

Afati për aplikim është 7 (shtat) ditë pune nga dita e publikimit të kësaj thirrje, nga data **22.09.2026** deri me datën **30.09.2026**, nga ora **08:30** deri në orën **15:30**.

Aplikimet dorëzohen në objektin e Komunës së Prishtinës për Drejtorinë e Mobilitetit, sipas dokumentacionit dhe procedurës së përcaktuar.

Vëmendje: Të gjitha përgjegjësitë dhe obligimet tjera lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi rregullohen sipas Rregullores nr. 01/346/02-257624/22, të datës 25.11.2022, dhe akteve ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje.

KRYEQYTETI – PRISHTINË
DREJTORIA E MOBILITETIT